



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3658 / Prot.
12

Patos, më 07/11/2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 05 NËNTOR 2024

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 12:00

Dëgjese publike me temë: “Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”.

Pjesëmarrës: Kryetari i bashkisë Patos z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtor e Urbanistikës znj. Boreta Murati, Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Gollosi, Drejtor e Projekteve znj. Ermenita Mici, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, përfaqësues të subjekteve private të cilët operojnë në territorin e njësisë administrative Patos, rreth 38 pjesëmarrës (banorë, kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të subjekteve që operojnë në njësinë Patos).

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”, jemi këtu sot për të prezantuar buxhetin 2025 dhe PBA-në 2025-2027.

Do t’ju lutesha që si gjithmonë të respektojme rregullat e dëgjesës, gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, mbiemër pasi takimi rregjistrohet dhe çdo



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për

pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur dhe ja kaloj fjalën administratës për të bërë prezantimin e materialit.

Kryetari i bashkisë Patos z. Fation Duro— përshëndetje të gjithëve dhe faleminderit që keni ardhur! Ne sot do të bëjmë prezantimin e buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së



**Kryetari i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

2025-2027. Fillimisht unë do t’ja lë fjalën Drejtoreshës së Financës për të bërë një prezantim

mbi kategoritë e burimeve financiare që janë të parashikuara dhe më pas unë do të bëj një prezantim të ndërhyrjeve të parashikuara në fushën e infrastrukturës.

Drejtoresha e Financës znj. Mimoza Shtembari- përshëndetje të gjithëve! Në paketën përfundimtare të buxhetit për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027 ne i kemi ndarë parashikimet për burimet financiare sipas 3 (tre) kategorive kryesore: të ardhurat vendore, transfertat e pakushtëzuar dhe ajo sektoriale. Ky është një vit buxhetor me tregues më të lartë nga ai i vitit 2024.



**Drejtoresha e financës
Znj. Mimoza Shtembari**
Dëgjese publike me temë:
**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Ashtu siç tregohet edhe në grafik 46% e zënë të ardhurat vendore, 34% transfertat të pakushtëzuara dhe 20% ajo sektoriale. Buxheti ynë mbështetet më shumë nga të ardhurat vendore dhe ky është një tregues shumë i rëndësishëm. 46% e të ardhurave mbulojnë investimet me vlerë absolute, të cilat janë të shpërndara në 17 programe ku peshën më kryesore e zë infrastruktura, ujitje dhe kullimi etj.

Kryetari i bashkisë Patos z. Fation Duro— unë dua të prezantoj pak pjesën e investimeve në të cilat është përfshirë një pjesë e mirë e ndërhyrjeve në infrastrukturë. Në pjesën e rrejtë



**Kryetari i bashkisë Patos
z. Fation Duro**
Dëgjese publike me temë:
**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

rrugor janë parashikuar disa emërtime projekti siç janë marrëveshja kuadër 2024-2026, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të bllokut të Vreshtit të lagjja e Re, ndërtimi i murit mbajtës me struktura metalike, rikualifikim i bllokut në Lagjjen Naftëtari, rikonstruksioni i kopshtit me drekë, rikualifikimi urban në lagjjen 1 Maj pranë shkollës Hekuran Maneku, në

lagj 1 Maj poshtë rrugës Koli Marku, rehabilitimi i sheshit të Lagjja e Re, ndërtim i kuartallit të ri në qytet, ndriçimi rrugor, ndërtim i trotuareve dhe shesheve të pallateve. Këto i përkasin ndërhyrjeve në rrjetin rrugor. Për sa i përket investimeve që përfundojnë zbatimin në vitin 2025 mund të përmendim rikonstruksionin e magjstralit kryesor dhe rrjetit të bendshëm të ujësjellsit në qytetin e Patosit, Lot II, rikonstruksionin e magjstralit kryesor dhe rrjetit të bendshëm të ujësjellsit në qytetin e Patosit, Lot III, rikonstruksioni i rrugës të lagjja e Re, Përroi Çam, rehabilitimi i Përroit dhe shtimi i flotës së mjeteve në Agjencinë e Shërbimeve Publike. Lidhur me marrëveshjen kuadër 2024-2026 përfshihen disa segmente rrugore në njësinë Zharrëz, rreth 12 segmente, 13 segment rrugore në Patos dhe 7 segmente rrugore në njësinë Ruzhdie.

Krahas investimeve nga ana e qeverisjes vendore janë përfshirë edhe investime nga ana e qeverisjes qendrore të cilat përfshijnë disa ndërhyrje kryesore siç janë rikonstruksioni i rrugës “Patos-Lagjja Mustafa Matohiti” dhe rruga e “Oficinës”, fasadat e pallateve, blloku nr.1, shëtitorja anës përroit etj. Gjithashtu investimet që janë në prioritet nga ana e bashkisë përfshijnë 4 (katër) ndërhyrje kryesore siç janë aplikimi për rikonstruksionin e banesave të familjeve në nevojë, aplikim për ndërtimin e një pallati për persona të pastrehë, ndërtimi i fushave të basketbollit në çdo lagje, rehabilitimi i Klubit të Pensionistëve dhe përshtatja për t’u transformuar në Klubin e Naftëtarëve. Në paketën përfundimtare të buxhetit përfshihen edhe programet buxhetore për Bujqësinë dhe Blegtorinë, ujitje dhe kullim, administrim pyjesh, mbrojtja e mjedisit, integrimi europian dhe aktivitete kulturore.

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- faleminderit për prezantimin e paketës



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

përfundimtare të buxhetit 2025 dhe PBA-së 2025-2027. Tani kalojnë në pjesën e diskutimeve dhe sugjerimeve tuaja. Ju lutem respektojme rregullat dhe prezantohemi përpara se të marrim fjalën.

Banor i qytetit të Patosit z. Sefret Kripa- E dëgjova me respekt dhe me shumë vëmendje, por më tepër dua të përqendrohem për vitin e ardhshëm. Lidhur me sistemimin e këtyre rrugëve ekzistuese me rërë bituminoze do bëhet ndonjë diçka sepse nuk kalojmë dot. Kisha dhe një shqetësim tjetër. Për ne pensionistët është parashikuar ndonjë diçka për buxhetin e vitit të ardhshëm?



**Banor i qytetit të Patosit
z. Sefret Kripa**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i paketës
fiskale për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-
2027”**

Nëntor 2024

Kryetar i shoqatës së Pensionistëve të Patosit z. Refat Ferataj- Unë jam nga lagjja e Re dhe tre pallate në qendër të qytetit kanë ngelur me rrugë të paasfaltuar, ata kanë nevojë për asfaltim. Një tjetër problem në lagjen Çame ka të bëjë me pastrimin e kanalit, i cili është i bllokuar. Sepse kur pastrohet kjo rregullon dhe problemet në komunitet.



**Kryetar i shoqatës së Pensionistëve të
Patosit
z. Refat Ferataj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Banor i qytetit të Patosit z. Bujar Shpërdheja- Unë banoj në Grizë dhe ne na mungojnë sinjalistikat rrugore në lagjen tonë. Ne jemi një lagje pa emër, pa tabelë. Unë propozoj që të vendoset emri i lagjes. Gjithashtu te rruga “Salia” na mbyti balta dhe duhet rregulluar. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza derdhen në lagjen tonë. Lagjja jonë nuk ka kanalizime të ujërave të zeza, por ne jemi aty të ndotur. Të falenderoj për ujin e pijshëm që na e mundësuar sepse po pinim ujë nga ujërat e zeza. Duhet të merren masa urgjente për kanalizimet e ujërave



**Banor i Grizës
z. Bujar Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

të zeza.

Kryetari i shoqatës Labëria z. Fatos Zhupi- Faleminderit kryetar për punën të përroi te rruga “Çame” fillimisht. Të shikohet mundësia për zgjerimin e urës te përroi “Enriko Veizi”.



**Kryetari i shoqatës Labëria
z. Fatos Xhufi**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Problem të dytë kam lidhur me rrugën e cila quhet “Enriko Veizi” dhe ka edhe një kryqëzim te pompa që quhet edhe ai “Enriko Veizi”. Rruga ka edhe një dalje që shkon te kthesa e Ballshit dhe quhet Muhamet Shehu. Kjo tani është dilem nëse vazhdon akoma ky emër apo ka ndryshuar. Faleminderit!

Kryetar i fshatit Rerës z. Shaban Ruçaj- ne kemi besim të plotë që punët do vazhdojnë dhe do bëhen avash avash. Në drejtim të parcelave ne jemi shumë të gëzuar që janë hapur. Për këtë unë e falenderoj dhe e përgëzoj. Në drejtim të rrugëve në Rerës që do të fillojnë nga puna unë jam në një mendim me parafolësit dhe duam që të vendosen tabelat me emrat e rrugëve dhe dëshirojmë që të vendoset një emër që i takon për t'u vendosur.



**Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Ruçaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Banor i qytetit të Patosit z. Fatmir Yzeiraj –unë e njoh mirë qytetin, arsimin dhe rininë.



**Banor i qytetit të Patosit
z. Fatmir Yzeiraj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Ne kemi pasur një fushë volejboli dhe të rejtat tona dolën kampione të të rejave në shkallë Republike. Në çdo shkollë ka qendra sportive, por ato janë vetëm për përdorim brenda procesit mësimor. Të ndërtohen objekte sportive në çdo lagje për volejbol dhe basketboll. Ne dikur kemi nxjerr kampion të Shqipërisë ne boks dhe është gjyna që tani mos të ketë mundësi për të patur një ambient të vogël për stërvitje. Edhe lojërat si shahu dhe dominoja nuk duan shumë shpenzime, majfton të shikohen se si mund të krijohen mundësitë. Lidhur me bibliotekën pse të mos ngrihen bibliotekat në çdo lagje në qoftë se e shikoni të arsyeshme.

Kryetar i Komitetit Veteranëve L.A.N.C Z. Harun Nazëraj – Patosi është kthyer në një kantier pune. Unë do dal pak jashtë teme dhe do flas lidhur me shëndetësinë. Të moshuarit i bëjnë analizat në Fier dhe pse mos të jenë aparaturat e duhura dhe këtu mbase duke bërë dhe ju ndonjë ndërhyrje.



**Kryetar i komitetit veteranëve L.A.N.C
Z. Harun Nazëraj**

**Dëgjësë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Kryetar i fshatit Frashër z. Irakli Zarka- Lidhur me Frashërin çfarë investimesh do të kemi sepse nuk u përmend fare pjesa e fshatit tonë?



**Kryetar i fshatit Frashër
z. Irakli Zarka**

**Dëgjësë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Kryetari i bashkisë Patos z. Fation Duro- unë po e nis përgjigjen nga pyetja e fundit. Lidhur me Frashërin dhe siç e thamë dhe herën e kaluar rrugën që lidh Frashërin me Novoselën është investim i Bankersit që do të mbyllet. Qendra shëndetësore shumë shpejt do bëhet ashtu siç duhet. Edhe për pjesën e ndriçimit do të fillojmë shumë shpejt dhe deri vitin tjetër një pjesë e mirë e ndriçimeve do të mbyllet.

Për pjesën e Kripallarëve duke qenë se në fund të vitit ka një rishikim të fondeve të trashëguara një nga rrugët që unë do të doja të ndërhyjmë si bashki është pjesa e lagjja e Kripallarëve duke qenë se një pjesë e mirë e rrugëve në atë lagje është e pakalueshme. Besoj që me fondet e trashëguara një pjesë do shkojë në lagjen e Kripallarëve. Lidhur me buxhetin e veçantë për invalidët ne kemi parashikuar një fond të vogël, por gjithsesi ne do të kemi aplikime herë pas here që bëhen nga Ministrinë përkatëse lidhur me këtë gjë.



**Kryetari i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Rruga te ish Vajguri është planifikuar sepse pak metra jënë diku të 100 m. Për kërkesën e pastrimit të kanalit të përroi deri te ura ka ngelur vetëm një pjesë e vogël, por që do vazhdojmë edhe më poshtë akoma. Lidhur me problemin e ngritur në Grizë mbi sinjalistikën rrugore dhe emëritmet mund të them se pothuajse 100% e rrugëve janë me emër. Ndoshta ka tabela që mungojnë, por te pjesa e sinjalistikës ne kemi bërë disa ndërhyrje dhe besoj se vitin e ardhshëm do mundohemi që këto 100% të rrugëve që janë me emra t'i vendoset edhe tabela përkatëse. Për pjesën e kanalizimeve të ujërave të ndotura në lagjen Grizë, siç e thash edhe më para AKUB e ka parashikuar sistemimin e ujërave të ndotur në këtë lagje. Edhe zgjerimi i urës te përroi do të bëhet, madje kemi edhe një plan pak a shumë se si do të ndërhyjmë. Rruga që del te rruga e Ballshit që e kishte emrin rruga “Muhamet Shehu” është në pronësi të bashkisë së Fierit. Për sa i përket ndriçimit nëpër lagje do të vazhdojmë do zgjerohet ndryshim dhe do të kemi pothuajse në të gjitha lagjet ndriçim. Për fushën e zezë që është ish fusha e lojërave me dorë do të bëjmë një projekt për ta kthyer siç ka qenë më para, por kjo do ngelet për vitin 2026. Për pjesën e menaxhimit të mbetjeve ne kemi filluar pak në Grizë pasi është një lagje që nuk ka kosha dhe s'ka ankesa pse nuk ka kosha. Kemi filluar një projekt në këtë lagje dhe secila familje ka një kontenier plastik dhe mbetjet merren një herë në javë dhe deri tani nuk kemi pasur ndonjë shqetësim nga banorët për pjesën e mbetjeve. Mund të shtojmë edhe ndonjë kontenier për pjesën e mbetjeve organike. Kjo do të vazhdojë në të gjithë vendin ku ka shtëpi private. Për sa i përket shahut dhe dominosë që u citua, në vitin e ardhshëm është planifikuar edhe rikonstruksioni i klubit të pensionistëve. Faleminderit!

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- në rast se nuk kemi pyetje të tjera atëherë unë do ta deklaroja të mbyllur këtë takim. Faleminderit për pjesëmarrjen!



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”**

Nëntor 2024

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba





